

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Agim Kuçi, me Zyrtaren ligjore Ibadete Sylja, në çështjen penale, kundër të pandehurit S.O.nga F.K., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, me shenjë PP.II.nr. 4067/13, të datës, 08.09.2015, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur në dt. 20.09.2018, në praninë e Prokurorit të Shtetit- Mendoji Kastrati, dhe të pandehurit S.O., në bazë të nenit 365 dhe 366 par 1 të KPPRK-së, me datën, 20.9.2018, mori, ndërsa me dt.19.10.2018, përpiloi me shkrim këtë:

## A K T G J Y K I M

**I akuzuari:**

**S.O.**, nga babai H., dhe nëna A., mbiemri i vajzërisë P., i lindur me datë ..., në fshatin L. të Komunës së F.K., me vendbanim në rr. "Y.S." nr.... në F.K., ku edhe jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme të makinerisë, pensionist, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

**I. I pandehuri S.O.**

Me dt. 13.02.2013, rreth orës 19:00, në shtëpinë e tyre fshatin L. të Komunës së F.K., pas një mosmarrëveshje në familjen e tij mes të pandehures T.O. dhe bashkëshortes së të pandehurit H.O., i pandehuri S.O.me dashje përdor forcën dhe sulmon duke e goditur me shuplakë në fytyrë të pandehurën T.O..

-me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së,

**II.**

Me datë kohë dhe vend si në dispozitivin nën I, në shtëpinë e tyre fshatin L. të Komunës së F.K., pas një mosmarrëveshje në familje, me dashje përdorin forcën sulmojnë njëri tjetrin, ku i pandehuri S.O. të pandehurin E.O., e godet disa herë me shuplaka-

-me këtë ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 187 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së,

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 49, 50, 51 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtit i shqipton,

## P Ë R C A K T O N

Për veprën penale nga dispozitivi i parë (I) dënim me gjobë në shumë prej 150 (njëqind e pesëdhjet euro)€.

Për veprën penale nga dispozitivi i parë (II) dënim me gjobë në shumën prej 150 (njëqind e pesëdhjetë euro)€.

Konform nenit 80 të KPRK-së gjykata i shqipton,

**D Ë N I M U N I K M E K U S H T**

Ashtu që të akuzuarin S.O.për veprat penale nga dispozitivi I dhe II e gjykon me dënim unik me gjobë në shumë prej 300 (treqind euro)€, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet i pandehuri që ti paguaj shpenzimet procedurale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, për ekspertizën e ekspertit mjeko-ligjor shumë prej 20 (njëzet euro)€, ndërsa për paushallin gjyqësor shumë prej 25 (njëzet e pesë euro)€, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara H.O., nga fshati L., Komuna F.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil – juridik.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr. 4067/13, të datës, 08.09.2015, e ka akuzuar të pandehurin S.O.nga F.K., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me datë, 20.09.2018, ku pas leximit të dispozitivit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata i ka mundësuar të pandehurit pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri S.O., në shqyrtimin gjyqësor me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.II.nr. 4067/13, të datës, 08.09.2015, ndihet fajtor për këtë veprim, i vjen keq për atë që ka ndodhur, pendohet për veprimin e marrë, deklaron që ishte veprim i çastit i cili ka ndodh mes anëtarëve të familjes i cili mund të ndodh në çdo familje dhe se rasti ka ndodhur në vitin 2013 dhe që nga ajo kohë nuk kemi pasur probleme, i premtun gjykatës se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe nuk do të kryej vepra të tilla penale as të tjera, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, po ashtu kërkon nga gjykata që gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit ti shqiptoj një dënim sa më të butë pasi që jetojm me një pension së bashku me bashkëshorten.

Pasi i pandehuri në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, ka pranuar fajësinë për veprën penale Sulmi nga neni 187 par. 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, gjykata në rastin konkret, pas marrjes se mendimit nga Prokurori i Shtetit, i cili është deklaruar që të aprovohet pranimi i fajësisë nga i pandehuri dhe pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3 të KPPRK-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 248 par. 1, nën – par. 4 të KPPRK-së, ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas pranimit të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes se kushteve në referim të nenit 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPRK-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që për të akuzuarin S.O., si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale, se ishte korrekt dhe me sjellje korrekte në gjykatë, ka shpreh keqardhje mbi faktin se nuk do ta përsëris asnjëher, i njëjti i kërkoj gjykatës që të ketë parasysh të gjitha këto rrethana e mija personale, që gjatë matjes dhe shqiptimit të dënimit ti shqiptoj një dënim sa më të butë, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, dhe nisur nga të gjitha këto të thëna gjykata i shqiptoi dënim me kusht me bindje se në rastin konkret është adekuat me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se me dënim me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit, i paraparë me nenin 50 të KPRK-së.

Në rastin konkret gjykata vlerësoi se dënimi me kusht i shqiptuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit sipas nenit 73. par.2 të KPRK-së, me shkallën dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikoj të të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KPRK-së.

E dëmtuara, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil, duke u bazuar në nenin 463 par.2 të KPP, kurse vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor dhe Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.1 pika 2.6 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 248 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Penal  
P.nr.3945/15, të dt:19.10.2018

Zyrtare Ligjore,  
Ibadete Syla,

Gjyqtari,  
Agim Kuçi

**UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.